

Policia kap armë e municion në Gjilan

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

23/03/2024 17:06

f

▶

↻

Policia e Kosovës ka njoftuar se ka konfiskuar një armë në qytetin e Gjilanit.

Sic thuhet në njoftim, njësitë i hetimeve të Stacionit Policor në Gjilan përmes rrugëve operative ka pranuar informacion se i dyshuari D.S. (viti i lindjes 1959, mashkull kosovar shqiptar) nga fshati Gumnishtë është në posedim të armëve pa leje përkatëse.

Në koordinim me prokurorin e shtetit dhe në mbështetje të njësiteve të tjera relevante sot me datën 23.03.2024 është kryer një kontroll në shtëpinë dhe objektet përcjellëse të të dyshuarit me ç’ rast janë gjetur dhe konfiskuar si prova materiale për gjykatën:

- Një (1) pushkë automatike AK47 e kalibrit 7.62 mm,
- Dy (2) karikatorë të armës automatike AK47,
- Njëzetë e katër (24) copë fishekë të kalibrit 7.62 mm dhe
- Një (1) pistoletë EKOL SPECIAL 99 e kalibrit 9 mm.

Tutje, Policia njofton se me urdhër të Prokurorit të Shtetit ndaj të dyshuarit do të ngritët kallëzim penal për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe rasti do të procedohet në procedurë të rregullt në Prokurorinë Themelore”.



Më shumë nga uebi

Nutricistja dhe neuroshkencëtarja thonë se

ARTIFICIAL INTELLIGENCE BRIDGES THE GAP BETWEEN THE GAP AND HUMAN

Gjëegjëza për fëmijë, por që as të rriturit nuk i zgjidhin

"Dhunon babanë tim që të ka mbajtur me bukë...", DEL

Dhëndri i Trump plan për të zhvilluar resorte turistike në

Artikuj të ngjashëm

March 23, 2024

"I balancuar dhe pozitiv" – Ambasadori francez për Asociacionin: Koha që...

March 23, 2024

Vdes në Spitalin e Pejës një i burgosur

March 23, 2024

Jemi në muajin e ramazanit: Por ky punëtorë nuk e ndalë...

March 23, 2024

Kurti përkujton Albright: Kosova gjithmonë mirënjohëse

March 23, 2024

O'Brien mesazh Serbisë për terroristët e Banjskës: Mbajtja përgjegjës duhet të...

March 23, 2024

Ambasadori britanik në Beograd: Modeli i Irlandës së Veriut zgjidhje e...